

L I G J
Nr.8662, datë 18.9.2000

PËR TRAJTIMIN SI TITULL EKZEKUTIV TË FATURËS SË KONSUMIT, TË SHITJES, TË BLERJES DHE FATURAT E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001; nr. 10 486, datë 26.11.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001; shtuar fjalë me ligjin nr. 10 486, datë 26.11.2011)

Fatura tatimore e konsumit, të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr.36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre.

Neni 2

Ligji nr.8369, datë 9.7.1998 “Për trajtimin e faturave të konsumit të energjisë elektrike, në ngarkim të subjekteve shtetërore (buxhetore dhe jobuxhetore) dhe të subjekteve private si tituj ekzekutivë” shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2750, datë 22.9.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.